



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr. 03-239

12.07.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 14 të Ligjit për media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr.184/13 dhe 13/14), pika 15 dhe 20 të Udhëzimi për përmbushje të detyrimeve për impresium dhe informacioneve në dispozicion për përdoruesit, ark.nr.01-4443 /1, datë 09.10.2018 , pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2023, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-2547/1 datë 20.06.2023 dhe Konkluzionin nr. 02-2749/6, datë 12.07.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 22-të mbajtur më 11.07.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 14 nga Ligji për media (LM), në mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor të transmetuar më 6 qershor 2023, në nivel shtetëror, as në shpicën prezantuese (hyrëse) dhe as në shpicën përmblylëse (në fund) nuk i publikoi të dhënat për impresium në edicionin e lajmeve në radio, me titull: " Lajme nga biznesi Metropolis", "Një minutë Lajm pozitiv", "Lajme Sportive" dhe "Lajme nga Radio Evropa e Lirë" .

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-2547/1, datë 20.06.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të LM, është kompetente për të kryer mbikëqyrjen administrative të punës së botuesve të mediave në aspekt të pajtueshmërisë së punës së tyre me detyrimet nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vendim për vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur është kryer cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si trup rregullativ kompetent mund t'i ndërmarrë, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen përkatësisht dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar në vend të dukshëm për çdo bartës individual të përmbajtjes (për shembull mostër e medias së shkruar dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të

dhënave të mëposhtme: emrin dhe adresën e selisë dhe redaksive të botuesit të medias, emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, pra redaktorët në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, në rastin e një mediumi të shtypur. Për transmetuesit, detyrimi i lartpërmendur zbatohet në atë mënyrë që të dhënat publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audiovizuale. Botuesi i medias është i detyruar në vend të përshtatshëm për çdo përmbajtje të publikojë këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës së publikuar, emrin dhe mbiemrin e personit, gjegjësisht të shoqërisë që ka të drejtën e autorit për përmbajtjet e publikuara, përveç atyre të shtypura programet mediatike dhe në radio, data e prodhimit (prodhimit) (muaji dhe viti) në rastin e një veprë audio/audiovizive, origjina e veprës audio/audiovizive, dhe nëse vepra është krijuar nga një prodhim i pavarur dhe informacione për të, emri i personi juridik, pra emri dhe mbiemri i personit që e ruan të mirën e përdorur kulturore ose vepër arkivore, përkatësisht riprodhimin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë shtojca (bashkëngjitja) e programit ose klipi nga bashkëngjitja (shtojca) e programit, përveç rasteve kur me marrëveshje të ndërsjellë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 15 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018 (Udhëzimin), në rastet kur transmetohen editoriale të shkurtra të lajmeve në radio (lajme flesh më të shkurtra se 5 minuta), mjafton që në shpicën përmbyllëse të publikohen të dhënat e mëposhtme: emri dhe mbiemri i redaktorit të edicionit konkret të lajmeve, emri dhe mbiemri i prezantuesit/gazetarit, emri dhe mbiemri i personit përgjegjës për drejtimin teknik të emisionit, data e prodhimit (prodhimit) (dita, muaji dhe viti), emri i subjektit tjetër nga i cili është marrë shtojca e caktuar ose pjesë e shtojcës, përveç rasteve nëse me marrëveshje reciproke nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 20 nga Udhëzimi i lartpërmendur, kur transmetohen programe të prodhimit të huaj, radiostacioni duhet të transmetojë shpicën origjinale.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 20 qershor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi shërbimin programor të SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, i transmetuar më 6 qershor 2023, në nëvel shtetëror, gjatë së cilës u konstatua shkelja e nenit 14 të LM, në mënyrë që transmetuesi si në shpicën hyrëse dhe në atë përmbyllëse nuk ka publikuar të dhënat për impresium në edicionet e lajmeve të radios, me titull: "Lajme nga biznesi i Metropolis", "Një minutë Lajm pozitiv", "Lajme Sportive" dhe "Lajme nga Radio Evropa e Lirë (në kundërshtim me pikën 15 të Udhëzimeve). Në kundërshtim me detyrimin nga pika 20 e Udhëzimit, përsëri, nuk është publikuar shpica origjinale për hyrje/dalje me të dhënat e detyrueshme për impresium për lajmet në radio që Shoqëria Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup e ndërmer nga - "Radio Evropa e Lirë"..

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10-2547/1 datë 20.06.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, më datë 23.06.2023, ka dërguar Shkresë me Nr. ynë ark.10-2547/2 datë 23.06.2023, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, arknr. 10-2547/1 datë 20.06.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të Shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt më datë 27.06.2023. Në afatin e paraparë, SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LM, Nr.ynë ark.10-2547/3 të datës 27.06.2023. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 11.07.2023, shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konstatoi ndaj SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup t'i shqiptojë masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 të LM, pika 15 dhe 20 të Udhëzimit për përmbushje të detyrimeve për impresium dhe informacioneve në dispozicion të shfrytëzuesve ark. nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Teksti i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark. nr 10 -2547/1 datë 20.06.2023, dhe Konkluzionin nr. 02-2749/6, datë 12.07.2023, për shkak të mosrespektimit të dispozitave nga LM, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur më 11.07.2023, ka miratuar Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do

të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Akvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.10- 2547/1 datë 20.06.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.